

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Semestri:	II-të
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi (ECTS):	6
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë synon të pajisë studentët e nivelit Master me njohuri të avancuara teorike dhe praktike mbi konceptet, proceset dhe strategjitë e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit (Supply Chain Management – SCM). Lënda fokusohet në integrimin e aktiviteteve nga furnizuesit tek konsumatorët finalë, duke përfshirë planifikimin, burimin, prodhimin, shpërndarjen dhe logjistikën, në mënyrë që të maksimizohet vlera për klientin dhe të arrihet avantazh konkurrues në tregjet globale. Gjatë kursit, studentët do të eksplorojnë praktikatat më të mira dhe qasjet inovative në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të reja, inteligjencës artificiale, analizës së të dhënave dhe transformimit digjital. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet menaxhimit të rrezikut, qëndrueshmërisë (sustainability), përgjegjësisë sociale të korporatave dhe ndikimit të globalizimit në zinxhirët e furnizimit. Përmes rasteve studimore, projekteve praktike dhe punës kërkimore, studentët do të zhvillojnë aftësi për të projektuar, analizuar dhe optimizuar zinxhirë furnizimi kompleks, si dhe për të marrë vendime strategjike që mbështesin qëllimet afatgjata të organizatës.
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë te studentët e nivelit Master njohuri të avancuara dhe aftësi praktike për planifikimin, organizimin, drejtimin dhe optimizimin e zinxhirit të furnizimit në mjedise komplekse dhe dinamike të biznesit. Lënda synon të pajisë studentët me kompetenca strategjike dhe analitike për të menaxhuar proceset nga furnizuesi tek konsumatori final, duke përdorur qasje inovative, teknologji të avancuara dhe praktika të qëndrueshme. Përmes kombinimit të teorisë me raste studimore dhe projekte praktike, studentët do të përgatiten të marrin vendime efektive për rritjen e efikasitetit, uljen e kostove, përmirësimin e shërbimit ndaj klientit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së organizatës në tregjet vendore dhe ndërkombëtare.
Rezultatet e pritura të	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje

mësimnxënies:	të: 1. Analizojë konceptet dhe parimet themelore të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit dhe rolin e tij strategjik në organizata, (ECTS:1) , 2. Vlerësojë modelet, strategjitë dhe teknikat e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit në kontekste të ndryshme ekonomike e gjeografike. (ECTS:1) , 3. Dizajnojë struktura të avancuara të zinxhirit të furnizimit duke marrë parasysh integrimin e proceseve, teknologjive digjitale dhe qëndrueshmërisë. (ECTS:1) , 4. Aplikoje metoda të avancuara të planifikimit të kërkesës, menaxhimit të inventarit dhe optimizimit të logistikës. (ECTS:1) , 5. Analizojë ndikimin e globalizimit, inovacioneve teknologjike dhe Inteligjencës Artificiale në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. (ECTS:1) , 6. Zhvillojë aftësi për të marrë vendime strategjike dhe operacionale për përmirësimin e efikasitetit të zinxhirit të furnizimit. (ECTS:0.5) , 7. Vlerësojë çështjet etike që dalin gjatë menaxhimit të zinxhirëve të furnizimit. (ECTS:0.5) ,		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet – detyra	1	15	15
Punë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	5	2	10
Punim seminarik (hulumtim)			
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetjak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			45
Përgatitja përfundimtare në provim	3	5	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Punimi, projektet, prezantim i punimit, etj	1	10	10
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	Fokusi i ligjeratave do të jetë në kuptimin e plotë të koncepteve teorike të zbatuara në praktikë përmes të mësuarit të bazuar në problem të kombinuara me Diskutim të rastit aktual të ngjarjeve (New Coke, FedEx, UPS) Diskutim i rastit (Walmart) Diskutim i rastit (BMW) Folësi i ftuar, Ushtrime kreative dhe simuluese: Ushtrime dhe shembuj të dizajnuara për të rritur kreativitetin dhe aftësitë e zgjedhjes së zgjidhjeve inovative. Analizat e literaturës: do të përfshijë ligjërata interaktive, diskutime në		

	grup, analiza rastesh, simulime, si dhe projekte praktike në bashkëpunim me biznese dhe organizata
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ♦ Aktivitete dhe Angazhim në mësim max 10 pikë (%), ♦ Hartimi/Prezantimi projektit/punim seminarik max 30 pikë (%), ♦ Provimi final max 60 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: ✿ Aktiviteti në mësim (5 pikë) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. ✿ Angazhimi (5 pikë) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminarik - vlerësohet me 30 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studentëve – jo më shumë se 2 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta. Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën. Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari

Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	10
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	10
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	10
Gjithsej:	30

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës Menaxhimi i Ndryshimeve.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 60 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Studenti ka të drejtë të nënshtrohet provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit.

Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjësuar.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studentit dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- **pyetje subjektive** të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studentit duhet të jetë në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit 60 pikë (%)

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

Notat në UShAF:

Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm
8	C	70 - 79	Shumë mirë
7	D	60 - 69	Mirë

	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm
	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve online për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.			
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% teori (90 orë) – 40% praktikë (60 orë) Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave në lëndën „ Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit” dhe aplikimit të tyre në aspektin praktik. Përmes këtij studimi synohet që studentët të fitojnë një kuptim më të qartë se si menaxhohen projektet në jetën reale, duke përdorur mjete dhe metoda të standardizuara. Nga gjithsej 150 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 60% teori (90 orë) – 40% praktikë (60 orë). • 60% teori (90 orë) janë të dedikuara për Ligjërata interaktive, Lexime dhe studim i literaturës si dhe Diskutime dhe analiza konceptuale • 40% praktikë (60 orë) janë dedikuara për Analizimi i zinxhirëve të furnizimit të kompanive vendore dhe ndërkombëtare, hartimin i një projekti për dizajnin e një zinxhiri furnizimi, Punë kërkimore mbi ndikimin e teknologjisë dhe AI në SCM, Ushtrime për planifikimin e kërkesës dhe menaxhimin e inventarit dhe Debate dhe diskutime mbi çështjet etike në SCM • Ndarja e ECTS sipas raportit 60%-40% Lënda „ Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit” vlerësohet me 6 ECTS, nga të cilat: - 3.6 ECTS (60%) i dedikohen pjesës teorike. - 2.4 ECTS (40%) i dedikohen pjesës praktike. Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike			
Literatura				
Literatura bazë	1. S. Panariti, <i>Menaxhimi i Operacioneve</i> , Tiranë 2017.			
Literatura shtesë	1. Sunil Chopra and Peter Meindl; Supply Chain Management: Strategy, Planning, and Operation (6th Edition), 2015. 2. Supply Chain Logistics Management, D. Bowersox, et al; 4th Ed.; ISBN 978-0078024054-13 3. Ivanov, D., & Dolgui, A. (2020) – Digital Supply Chain Twin: The impact of Industry 4.0 on supply chain resilience and performance.			
Plani i dizajnuar i mësimi:				
Java	Ligjërata që do të zhvillohet			
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndëve, Hyrje dhe kuadri konceptual • Prezantimi i lëndës, objektivat dhe rezultatet e pritshme të të nxënësve • Natyra e firmave dhe evolucioni i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit			

	• Konceptet bazë: logjistika, rrjetet e furnizimit, zinxhiri i vlerës • Roli strategjik i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit në konkurrencën globale Rezultatet e Nxënies që mbështet R1
Java e dytë	Modelet dhe strategjitë e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit • Modelet tradicionale dhe moderne të menaxhimit • Strategjitë “Lean” dhe “Agile” në zinxhirin e furnizimit • Menaxhimi i çmimeve dhe të ardhurave në një zinxhir furnizimi • Përparësitë krahasuese në zinxhirët globalë të furnizimi Rezultatet e Nxënies që mbështet R2,6
Java e tretë	Zinxhirët e furnizimit të shekullit të 21-të • Evolucionin nga logjistika tradicionale te rrjetet globale të furnizimit • Karakteristikat kryesore të zinxhirëve modernë (shpejtësia, fleksibiliteti, integrimi teknologjik) • *Globalizimi dhe ndikimi i tij në menaxhimin e furnizimit • Roli i teknologjive digjitale (AI, IoT, Blockchain, Big Data) • Tendencat e reja në shpërndarje dhe transport (last-mile delivery, dronë, automjete autonome) • Menaxhimi i rrezikut dhe qëndrueshmërisë në zinxhirët globalë • Raste studimore (Amazon, Apple, Maersk) Rezultatet e Nxënies që mbështet R1,5
Java e katërt	Etika Menaxheriale si pjesë përbërëse dhe e domosdoshme në Menaxhimin e Furnizimit Zinxhiror • Kuptimi i etikës menaxheriale në zinxhirin e furnizimit • Kodet e sjelljes dhe standardet ndërkombëtare (ISO 20400, UN Global Compact) Çështje etike në marrëdhëniet me furnitorët (korruptimi, favorizimi, konkurrenca e pandershme) Transparenca dhe gjurmueshmëria në zinxhirin e furnizimit • Menaxhimi i punës së detyruar dhe abuzimeve me të drejtat e punëtorëve • Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia sociale e korporatave (CSR) • Raste studimore mbi shkeljet dhe praktikatat e mira (Nike, H&M,) Rezultatet e Nxënies që mbështet R7
Java e pestë	Përparësitë Krahasuese dhe Menaxhimi i Furnizimit Zinxhiror • Teoria e përparësive krahasuese dhe aplikimi në zinxhirët e furnizimit • Burimet dhe avantazhet konkurruese të vendeve dhe kompanive • Menaxhimi i furnitorëve ndërkombëtarë bazuar në përparësitë krahasuese • Optimizimi i kostove dhe efikasitetit përmes specializimit gjeografik • Roli i teknologjisë në shfrytëzimin e përparësive krahasuese • Balancimi i përparësive krahasuese me rreziqet e globalizimit • Raste studimore (Tesla, Toyota, Zara) Rezultatet e Nxënies që mbështet R2,6
Java e gjashtë	Ekonomia rrethore dhe riciklimi në menaxhimin e furnizimit • “Reverse Logistics” dhe rikuperimi i produkteve • Qëndrueshmëria dhe certifikimet mjedisore

	Rezultatet e Nxënies që mbështet R3,7
Java e shtatë	Hyrje në planifikimin e operacioneve • Roli i planifikimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit • Objektivat strategjike dhe operacionale të planifikimit të prodhimit • Lidhja midis planifikimit të prodhimit dhe planifikimit të burimeve • Integrimi i planifikimit të prodhimit me planifikimin e materialeve (MRP) • Planifikimi i burimeve të prodhimit (RRP, CRP) • Strategjitë e planifikimit të prodhimit Make-to-Stock (MTS), Make-to-Order (MTO), Strategjitë “Push” dhe “Pull” në prodhim • Planifikimi i kapaciteteve • Matja e kapacitetit prodhues • Balancimi i kapacitetit me kërkesën • Qëndrueshmëria dhe prodhimi i gjelbër • Efikasiteti energjetik dhe reduktimi i mbetjeve • Integrimi i konceptit “Lean Manufacturing” me “Green Production” Raste studimore • Toyota Production System (TPS) • Siemens Integrated Production Planning • Prodhimi i personalizuar në Tesla Rezultatet e Nxënies që mbështet R7
Java e tetë	Zinxhiri global i furnizimit • Struktura e rrjeteve ndërkombëtare të furnizimit • Menaxhimi i operacioneve globale Efekti ekonomik i zinxhirëve të furnizimit brenda korporatave Raste diskutimi: Walmart, BMW Rezultatet e Nxënies që mbështet R8,5
Java e nëntë	Menaxhimi i ndryshueshmërisë brenda një rrjeti të zinxhirit të furnizimit Kuptimi i ndryshueshmërisë (variabilitetit) në zinxhirin e furnizimit Llojet e ndryshueshmërisë • Ndryshueshmëria e kërkesës • Ndryshueshmëria e ofertës • Ndryshueshmëria e kohës së dorëzimit Efekti “Bullwhip” – shkaqet dhe pasojat Strategjitë për uljen e ndryshueshmërisë • Planifikimi i koordinuar i kërkesës • Partneritetet me furnitorë dhe klientë • Menaxhimi i stokut sigurues Përdorimi i teknologjive digjitale për parashikim më të saktë Roli i bashkëpunimit dhe ndarjes së informacionit në reduktimin e ndryshueshmërisë Raste studimore (Procter & Gamble, Dell) Rezultatet e Nxënies që mbështet R4
Java e dhjetë	Efekti ekonomik i zinxhirëve të furnizimit brenda korporatës • Roli i zinxhirit të furnizimit në krijimin e vlerës ekonomike

	- Analiza e kostove totale të pronësisë (Total Cost of Ownership) - Ndikimi i efikasitetit të zinxhirit të furnizimit në fitim dhe ROI - Menaxhimi i kapitalit qarkullues përmes optimizimit të zinxhirit të furnizimit - Ndërlidhja midis strategjisë së korporatës dhe strategjisë së zinxhirit të furnizimit - Roli i inovacionit dhe automatizimit në uljen e kostove - Raste studimore (Unilever, Toyota) Rezultatet e Nxënies që mbështet R6
Java e njëmbëdhjetë	Transporti dhe Distribrimi i Menaxhimit dhe Furnizimit Zinxhior, - Menaxhimi i transportit ndërkombëtar dhe kombëtar - Planifikimi i shpërndarjes dhe optimizimi i rrugëve - Shërbimet “Third Party Logistics” (3PL) dhe “Fourth Party Logistics” (4PL) - Raste studimore: FedEx, UPS Rezultatet e Nxënies që mbështet R4
Java e dymbëdhjetë	Standardet dhe certifikimet ndërkombëtare në menaxhimin e furnizimit - ISO 9001, ISO 28000, ISO 20400 - Rëndësia e auditimeve dhe pajtueshmërisë Rezultatet e Nxënies që mbështet R5
Java e trembëdhjetë	Koordinimi i furnizimit dhe sistemet e informacionit - Koordinimi i aktorëve në zinxhirin e furnizimit - Teknologjitë e informacionit dhe sistemet ERP, SCM, TMS, S - Integrimi i të dhënave dhe roli i “Cloud Computing” Rezultatet e Nxënies që mbështet R3
Java e katërmëdhjetë	Transformimi i Zinxhirit të Furnizimit në Epokën e Inteligjencës Artificiale: Inovacion, Efikasitet dhe Sfidë - Aplikimi i Inteligjencës Artificiale në planifikimin e kërkesës dhe ofertës - Transformimi i zinxhirit të furnizimit përmes “Digital Twins” dhe simulimeve inteligjente - Roli i IA në menaxhimin proaktiv të rrezikut në zinxhirët globalë të furnizimit - Integrimi i IA me teknologjitë e tjera si IoT dhe Blockchain në logjistikë - Inovacionet në automatizimin e magazinimit dhe shpërndarjes (Smart Warehousing) Rezultatet e Nxënies që mbështet R3,5
Java e pesëmbëdhjetë	Raste studimore dhe projekte praktike - Analiza e rasteve reale nga kompani globale - Projekte grupore për zgjidhjen e problemeve të zinxhirit të furnizimit - Prezentime dhe diskutime kritike Rezultatet e Nxënies që mbështet R3,4,5,6,7
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i detyruar të ndjekë rregullisht ligjëratat dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, ruajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është i detyrueshëm. Gjatë orëve të leksioneve dhe ushtrimeve, NDALOHET ngrënia, pëshpërtitja që pengon punën në klasë dhe përdorimi i celularëve. Në të njëjtën kohë, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të	

mos përdoren gjatë leksioneve ose ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (përfshirë plagjiaturën, kopjimin e punës së një personi tjetër, përdorimin e mjeteve ndihmëse të paautorizuara të provimit, mashtrimin, etj.) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punimit të paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë nxënësit të verifikojë punën e tij. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuizit të papritur ose çdo veprimi tjetër që gjykohet i nevojshëm nga pedagogu.